

RREGULLORE

Aleanca e gjelbert

PËRMBAJTJA

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
Neni 1 Objekti i Rregullores	3
Neni 2 Parime Themelore	3
Neni 3 Qëllimi dhe Objektivat	3
Neni 4 Misioni i Aleancës së gjelbërt	4
Kreu II ORGANIZIMI i Aleances së gelbërt	4
Neni 5 Përbërja e Aleances së gjelbërt	4
Neni 6 Anëtarët	5
NENI 7 Të drejtat dhe Detyrimet e Anëtarëve	7
Neni 8 Largimi nga Aleanca e gjelbërt	7
Neni 9 mbledhja e parë	8
Neni 10 Mbledhjet e Aleancës së gjelbërt	9
Neni 11 Mbledhjet e Departamenteve	10
Neni 12 përzgjedhja e kordinatorëve të Departamenteve	10
Neni 13 Kompetencat dhe detyrat e kordinatorëve	11
Neni 14 Konfidencialiteti	12
Neni 15 Dispozita Përfundimtare	12

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1
OBJEKTI I RREGULLORES

Ky dokument rregullon organizimin dhe funksionimin e Aleances së gjelbërt, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e organeve përkatëse.

NENI 2
PARIME THEMELORE

Kjo rregullore ndërtohet dhe siguron se parimet themelore të Aleancës së gjelbërt janë:

- a. Respektimi i të drejtave të anëtarve pjesëmarrës në Alencë pa dallime dhe diskriminim gjinor, social, politik, rracor, fetar apo çdo formë tjetër diskriminimi.
- b. Respektimin e autonomisë së secilit anëtar, statuteve të organizatave dhe aktivisteve që përfaqësojnë në Alencë dhe nxitjen e vlerave bashkëpunuese ndërmjet anëtarëve.
- c. Mbrojtjen e interesave më të larta dhe të drejtave të të rinjve.
- d. Të gjithë antarët shënohen në listen e antarëve duke dhënë vullnetarisht informacione mbi kontaktet e tyre.

NENI 3
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe modaliteteve brenda organizatave, forumeve, aktivisteve, rrjeteve, grupimeve, anëtare të kësaj Aleance.
2. Duke nënshkruar këtë rregullore, organizatat, forumet, aktivistet, rrjetet, grupimet, anëtarët bien dakord dhe pranojnë që të respektojnë atë, duke ushtruar të drejtat dhe detyrat e tyre të dala prej saj duke siguruar mbarëvajtjen e punës për arritjen e objektivave të vendosur prej Aleancës.

NENI 4
MISIONI I ALEANCËS SË GJELBËRT

1. Aleanca e gjelbërt është një organ këshillimor i Bashkisë Tiranë, nën kompetencat e Këshillit të Bashkisë Tiranë/Drejtorisë së Rinisë, i cili, bazuar në parimin e përfshirjes aktive së komunitetit në vendimarrjen lokale dhe demokracinë direkte, siguron pjesëmarrje aktive të anëtarve të saj në propozimin, hartimin, përmirësimin e politikave rinore/ strategjive lokale për mjedisin në Bashkinë e Tiranës.
2. Aleanca e gjelbërt realizon monitorimin e planeve/strategjive lokale rinore për të mjedisin .
3. Aleanca e Gjelbërt advokon për çështje që prekin interesat e të rinjve për mjedisin.
4. Aleanca ka për qëllim influencimin e vendimeve të Bashkisë Tiranë lidhur me çështjet mjedisore që prekin të rinjtë dhe komunitetet në të cilat ata jetojnë.

KREU II
ORGANIZIMI I ALEANCËS SË GJELBËRT

NENI 5
PËRBËRJA E ALEANCES SË GJELBËRT

1. Aleanca e Gjelbërt përbehet nga disa organizime të formave të ndryshme të karakterit ligjor dhe informal në fushën e mjedisit duke përfshirë organizata, forume, rrjete, grupe rinore informale si më poshtë:
 - a. Organizatat Mjedisore që operojnë nën juridiksionin territorial të Bashkisë Tiranës.
 - b. Grupet mjedisore informale, individ, aktivist
 - c. Forumet Politike Rinore mjedisore
 - d. Rrjetet Mjedisore në nivel lokal
 - e. Organizata që kanë programe të paktën 1 vjeçare për të mjedisin.
2. Këto forma organizimi janë grupuar në 4 departamente kryesore:

- a) Departamenti i Organizatave
- b) Departamenti i Forumeve dhe grupeve mjedisore informale
- c) Departamenti i Rrjeteve mjedisore
- d) Departamenti i Aktivisteve

NENI 6

ANËTARËT

1. Anëtarët e Aleancës së Gjellbërt janë persona fizikë që përfaqësojnë një prej organizmave të përmendur në Nenin 5 Pika 1, të cilët kanë pranuar të respektojnë dhe ndjekin këtë rregullore.
2. Çdo organizatë, forum, rrjet, grupim, aktivist, duhet të marrë masa për një pjesëmarrje të rregullt me të paktën një përfaqësues të tyre në mbledhjet, aktivitetet dhe nismat e Aleancës së Gjellbërt.
3. Anëtarësimet për Aleancës e Gjellbërt hapen një herë në vit, përgjatë 2 javëve të dyta të muajit "Janar" dhe vlefshmëria e tyre është me afat 1 vjeçar, me mundësi ri-aplikimi. Çdo anëtar ka të drejtën e tij të përfaqësohet me anë të dy përfaqësuesve që autorizohen nga përfaqësuesi ligjor i organizatës, forumit, rrjetit, grupimit me anë të një shkrese lëshuar prej tij apo me kërkesë të vet individit.
4. Anëtarësimi për organizata/grupe informale të reja realizohen përmes procesit të aplikimit i cili përmban:
 - a. Plotësimin e një formulari online për të dhënat e mëposhtme:
 - i. Emrin dhe formën e organizimit;
 - ii. Informacion mbi aktivitetin dhe përfshirjen e të rinjve në punën e tyre;
 - iii. Emrat e dy përfaqësuesve (pjesëmarrës në takimet e Aleancës);
 - b. Vlerësimi nga një komision brenda Aleancës përmes kritereve të:
 - i. Eksperiencës - minimalisht 1 vit eksperiencë në shoqërinë civile;
 - ii. Statuti - të përcaktojë punën me të rinjte dhe/ose të jetë duke zbatuar projekte për të mjedisin me kohëzgjatje minimum 1 vjeçare;
 - iii. Të operojë në qytetin e Tiranës.
5. Komisioni i vlerësimit të aplikimeve në departamentin e organizatave ngrihet në javën e parë të çdo muaj Shkurt dhe përbëhet nga minimalisht 3 përfaqësues të organizatave të ndryshme, anëtare ekzistuese të Aleancës me eksperience të paktën 4 vjeçare në aktivitete të shoqërisë civile. Komisioni i Vlerësimit të aplikimeve për departamentin e organizatave ka përgjegjësi:
 - a. Kontrollimin e çdo aplikimi për departamentin e organizatave ;

- b. Mbajtjen e procesverbalit të takimit; (bashkëlidhur rregullores Aneksi A)
 - c. Përzgjedhjen e antarve sipas kritereve të nenit 6, pika 4, b ;
 - d. Njoftimin e antarëve për zgjedhjen ose moszgjedhjen e tyre për tu bërë pjesë e Aleancës së Gjelbërt.
6. Anëtarësimi në departamentin e forumeve politike kryhet përmes njoftimit të shkruar, drejtuar departamentit përkatës, ku bëhet me dije vendimi i regjistrimit të partisë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, emrat e dy përfaqësuesve të atashuar nga forumi dhe kontaktet e tyre. Anëtarësimi i një forumi të ri politik është automatik dhe njoftohet nga koordinatori i departamentit përkatës në mbledhjen e parë pasardhëse. Me nënshkrimin e kësaj rregulloreje, të gjitha forumet rinore mjedisore të partive politike aktive në Shqipëri konsiderohen anëtare të Aleancës.
7. Çdo organizëm i përfaqësuar në Aleancë konsiderohet anëtar me të drejta të barabarta dhe detyrime të plota.
8. Drejtoria e Rinisë pranë Bashkisë Tiranë merr pjesë në çdo mbledhje të Aleanca e Gjelbërt dhe ushtron të njëjta të drejta si çdo antar i Aleancës së Gjelbërt, por pa të drejtë vote.

NENI 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Pas bërjes me dije të anëtarësimit në Aleancën e Gjelbërt dhe njohjes me rregulloren, përfaqësuesit e organizmave kanë të drejtat e mëposhtme:
 - a. Të bashkëpunojnë midis tyre për të nxitur nisma dhe veprime të përbashkëta të cilat do të ushtrojnë ndikim në punën, vendimet dhe politikat mjedisore të Bashkisë Tiranë, si dhe institucioneve të ndryshme publike në nivel lokal vartëse nga kjo e fundit.
 - b. Të propozojnë zgjidhjen e problematikave që lidhen me çështje mjedisore dhe zbatimin efektiv të politikave të lidhura me to.
 - c. Të zhvillojnë marrëdhënie ndërmjet tyre për të advokuar si dhe për të ndërmarë nisma dhe iniciativave të përbashkëta në emër të Aleancës së Gjelbërt.
 - d. Të marrin vendime të përbashkëta me anë të votimit sipas parimit "një anëtar një votë".
 - e. Të thërrasë një mbledhje jashtë rradhe duke lajmëruar minimalisht 5 ditë pune më parë.
 - f. Të tërheqin anëtarësinë e tyre në Aleancë duke hequr dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tyre.

2. Pas bërjes me dije të anëtarësimit në Aleancën e Gjellbërt dhe njohjes me rregulloren, përfaqësuesit e organizmave kanë detyrimet e mëposhtme:
 - a. Të marri masa për një pjesmarrje të rregullt të përfaqësuesve të tyre në mbledhjet, aktivitetet dhe nismat e Aleancën e Gjellbërt.
 - b. Të ushtrojnë të gjithë të drejtat e tyre sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
 - c. Të lajmërojnë tërheqjen e tyre paraprakisht sipas procedurës përshkruar në Nenin 8 të kësaj rregulloreje.

NENI 8

LARGIMI NGA ALEANCA E GJELBËRT

1. Çdo anëtar ka të drejtën e tërheqjes nga Aleanca e Gjellbërt. Kjo e drejtë ushtrohet përmes dërgimit të shkresës që njofton Aleancën dhe departamentin që bën pjesë me arsyet e largimit. Shkresa nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor dhe/ose drejtuesi ekzekutiv. Tërheqja e anëtarit është e menjëhershme dhe bërja me dije e vendimit për largim bëhet në çdo kohë. Afati i njohjes së Aleancës dhe departamentit përkatës me shkresën është 1 (një) muaj që nga data e nënshkrimit. Në rast të ndryshimit të vullnetit për tu larguar, organizmi duhet të ndjekë procedurat sipas përshkrimit në Nenin 6.
2. Çdo anëtar i Aleancës ka të drejtën të propozojë ndalimin e anëtarësisë për një anëtar tjetër. Kjo e drejtë ushtrohet përmes kërkesë-propozimit në mbledhjet e Aleancës, nën të cilin sqarohen arsyet e këtij propozimi. Aleanca e Gjellbërt ka të drejtë të vendosë nëse do të shqyrtojë kërkesë-propozimin përmes procesit të votimit me 50%+ të votave.
3. Largimi i antarit sipas pikës 2 të këtij neni, hyn në fuqi nëse në mbledhjen pasuese të Aleancës së Gjellbërt, antarët me anë të votimit me shumicë të cilësuar, votojnë largimin e tij.
4. Aleanca ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ndërpresë anëtarësinë e një organizmi nëse konstatohet se:
 - a. Struktura (anëtari) ka ndërprerë aktivitetin, prej të paktën 1 (një) viti kalendarik.
 - b. Anëtari nuk merr pjesë në minimalisht 70% të veprimtarisë së departamentit.
 - c. Anëtari nuk merr pjesë në minimalisht 70% të mbledhjeve të planifikuara gjatë vitit.

- d. Organizata anëtare nuk merr masa ndaj përfaqësuesit të saj në Aleancë nëse ky i fundit thyen etikën e komunikimit përgjatë veprimtarive të Aleancës dhe takimeve të departamentit përkatës, duke përfshirë edhe ato në të cilat Aleanca përfaqësohet.
5. Vendimi për largimin e antarit për pikën 4 të këtij neni merret me 50%+1 të votave të antarëve të pranishëm në mbledhje.

NENI 9

MBLEDHJA E PARË

1. Mbledhja e parë e Aleancës zhvillohet javën e dytë të muajit "Shkurt" ose javën e tretë të muajit "Shkurt". Aleanca e Gjelbërt e zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 15 ditë pune pas mbylljes së procesit të vlerësimit për anëtarësimet e reja.
2. Mbledhja e parë e Aleancës thirret nga çdo anëtar i Aleancës, në mbështetje të pikës së parë të këtij neni. Në rast se asnjë nga anëtarët nuk e ushtron këtë të drejtë brenda afatit të parashikuar, atëherë Aleanca mblidhet vetë të mërkurën e fundit të çdo muaji Shkurt, në orën 11 në ambientet e Drejtorisë së Rinisë.
3. Mbledhja e parë e Aleancës së Gjelbërt, është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e antarëve të tij.
4. Në mbledhjen e parë të Aleancës vendosen datat e para të takimeve të secilit departament.
5. Në mbledhjen e parë lexohet rregullorja, vohet me shumicë të thjeshtë sipas parimit “një antar një votë” dhe nënshkruhet nga të pranishmit. Nëse nuk arrihet miratimi i saj, diskutohen në mbledhje ndryshimet që nevojiten dhe rihidhet në votim.

NENI 10

MBLEDHJET E ALEANËS SË GJELBËRT

1. Aleanca e Gjelbërt mblidhet minimalisht 1 herë në muaj për të analizuar, planifikuar dhe organizuar nisma dhe aktivitetet e përbashkëta që do të ndërmerren në emër të Aleancës.
2. Në mbledhjet e Aleancës së Gjelbërt, Drejtoria e Rinisë pranë Bashkisë Tiranë merr pjesë si antar vëzhgues dhe monitorues, duke mos pasur të drejtë vote në vendimarrjen e Aleancës së Gjelbërt.

3. Në mbledhjen e Aleancës së gjelbërt organizatat, forumet, aktivistët, grupimet, anëtarë do të njihen në mënyrë të hollësishme me rezultatet e arritura përgjatë një muaji.
4. Organizatat, forumet, aktivistët, grupimet, rrjetet, anëtarë, duhet të marrin pjesë të paktën 70% në mbledhjet e Aleancës së Gjelbërt (nëse një prej strukturave rinore mungon 3 herë rradhazi, atëherë Aleancës ka të drejtë të diskutojë dhe marrë masa në lidhje me frekuentimin).
5. Në mbledhjet e Aleancës së Gjelbërt marrin fjalën në fillim kordinatorët e departamenteve duke raportuar ecurinë e mbledhjeve të tyre dhe në varësi të tematikave/çështje të reja diskutohet në lidhje me mënyrat e zgjidhjes dhe vendimet që Aleanca duhet të marrë për secilën çështje.
6. Moderimi i mbledhjes së Aleancës realizohet nga kordinatorët e departamenteve me rotacion çdo muaj.
7. Aleancës së Gjelbërt mund të mblidhet në takime të jashtëzakonshme në varësi të çështjeve dhe situatave të krijuara për diskutim. Takimi kërkohet nga kordinatori i departamentit që ka marrë njoftim mbi çështjen për diskutim.
8. Aleanca e Gjelbërt harton plane strategjike, raporte vjetore dhe komunikime zyrtare drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë; Drejtorisë së Rinisë; Projekteve Strategjike, Komisionit Të Politikave Mjedisore; Këshillit Bashkiak; Këshillave drejtues apo administrativ të institucioneve; enteve; administratës publike; komisioneve dhe organizimeve të tjera në përgjithësi.

NENI 11

MBLEDHJET E DEPARTAMENTEVE

1. Departamentet do të mblidhen të paktën 1 herë në muaj ose më shumë, kur shihet e nevojshme, për të diskutuar/analizuar dhe marrë vendime mbi punën dhe ecurinë e secilit departament dhe për të dorëzuar pranë Aleancës së Gjelbërt propozime dhe raportime.
2. Minimumi i pjesëmarrjes së antarëve të departamenteve është 70% të takime të përcaktuara në vit.
3. Në rast se ndonjë anëtar i departamenteve nuk përmbush pikën 2 dhe tregon mungesë serioziteti/interesi për të çuar përpara punën e Aleancës, atëherë ky i fundit ka të drejtë që së bashku me organizatën respektive (që anëtari/ja përfaqëson) të gjejnë një zgjidhje në të mirë të bashkëpunimit dhe ecurisë së punës në Aleancës.
4. Nëse nuk gjendet një zgjidhje për situatën e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, departamentet propozojnë në mbledhje passardhëse të Aleancës largimin e përfaqësuesit nga Aleanca e Gjelbërt me votim të thjeshtë. Përfaqësuesi i çdo forme të antarsisë në Aleancë, ndaj të cilit është marrë masa e largimit të personit përfaqësuesit, duhet që brenda muajit të paraqesë, në mbledhjen e ardhshme të

departamentit ku bën pjesë, emrin e personit përfaqësues. Në rast se nuk propozohen emra për përfaqësim, aplikohet neni 8, pika 4, b. (largimi i antarit nga Aleanca e Gjelbërt).

NENI 12

PËRZGJEDHJA E KORDINATORËVE TË DEPARTAMENTEVE

1. Për përzgjedhjen e koordinatorëve, duhet të respektohen kriteret si më poshtë:
 - a) Barazia gjinore, atëherë kur është e mundur (2 vajza 2 djem).
 - b) Anëtarët duhet të përfaqësojnë të rinj nga komunitete dhe fusha mjedisore.
 - c) Çdo kordinator kandidues duhet të jetë mbi moshën 16 vjeç dhe nën moshën 30 vjeç.
2. Aleanca e Gjelbërt përzgjedh 4 kordinatorët e departamenteve. Çdo departament realizon votime me shumicë të thjeshtë të kandidaturave që aplikojnë për kordinator departamenti. Çdo departament nxjerr nga votimet e tij, max 3 kandidatura për ti propozuar pranë Aleancës së Gjelbërt. Kandidaturat paraqiten pranë Aleancës i cili zgjedh me shumicë të thjeshtë 4 kordinatorët e departamenteve sipas Nenin 5, pika 2:
3. Për departamentin e organizatave, kandidaturat e përzgjedhura për votim në Aleancë duhet të paraqesin përpara tij:
 - a. 1 letër reference nga organizata të Shoqërisë Civile të cilat operojnë në Tiranë;
 - b. CV ku duhet të bashkangjisi një dokument - raport me aktivitetet të zhvilluara;

NENI 13

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KORDINATORËVE

1. Kordinatorët e departamenteve kanë për detyrë që të njoftojnë të gjithë përfaqësuesit e organizmave që bëjnë pjesë në departamentet përkatës për çdo informacion, takim, event, aktivitetet, nëpërmjet:
 - a. Adresës së Emailit;
 - b. Grupit të mbyllur në Facebook të secilit departament;
 - c. Celularit.
2. Kordinatorët e departamenteve përgjatë takimeve të departamenteve kanë për detyrë të mbajnë dhe zbardhin minutat përkatëse në çdo takim. Ata duhet të përgatisin një dokument përmbledhës i cili duhet ti dërgohet me e-mail anëtareve të departamentit brenda 48 orësh.
3. Kordinatorët e departamenteve kanë për detyrë të moderojnë mbledhjet dhe të bëjnë një përshkrim të shkurtër të mbledhjes paraardhese.

4. Kordinatoret kanë për detyrë të prezantojnë një herë në muaj përpara aleancës një përmbledhje të punës 1-mujore të departamentit përkatës.
5. Drejtuesi i departamentit i mbështetur nga antarët e departamentit (me votim 2/3 e antarve), mund të thërrasi mbledhje të jashtëzakonshme të Aleancës për çështje që nuk kanë qënë në dijeni apo problematika që kanë dalë mbas mbledhjes normale të Aleancës së Gjelbërt.
 6. Nëse konstatohet nga antarët e departamentit që sjellja e kordinatorit bie ndesh me rregulloren e brëndshmen, parimet e Aleancës së Gjelbërt., me shumicë të cilësuar 2/3 votohet për paraqitjen në Aleancën e Gjelbërt të propozimit për shkarkimit të tij nga detyra.
 7. Në rast se kordinatori kërkon largimin e tij nga posti që mban, duhet të njoftojë minimalisht 1 muaj përpara në departamentin e tij dhe Aleancën së Gjelbërt. në mbledhjen vijuese, shoqëruar me një letër shpjeguese.

ENI 14

KONFIDENCIALITETI

1. Respektimi i konfidencialitetit të informacionit / punës/ aktiviteve/ nismave të Aleancës. Informacion konfidencial është çdo njohuri që mund të komunikohet apo dokumentohet, pavarësisht nga forma, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëme të rënda dhe serioze veprimtarisë, imazhit dhe reputacionit të Aleancës së Gjelbërt dhe antarëve të tij.
2. Klasifikohen si informacion konfidencial:
 - a. Planet për projekte, ide dhe veprimtari që i propozohen Aleanca apo departamenteve përkatëse;
 - b. Vendimet që merren deri në momentin e publikimit të tyre;
 - c. Çdo informacion tjetër i rëndësishëm për mirëfunksionimin, mbarëvajtjen e punës imazhin dhe reputacionin e Aleancës së Gjelbërt. dhe antarëve të tij;
 - d. Çdo informacion i cili në momentin e marrjes është cilesuar si konfidencial.
3. Organizatat, forumet, aktivistët, grupimet kanë për detyrë të ruajnë informacionin konfidencial dhe të mos ju'a bëjnë atë të ditur palëve të treta. Detyrimi për ruajtjen e informacionit konfidencial vazhdon deri në 6 muaj pas largimit të tyre nga Aleanca.
4. Nëse një prej anëtarëve të Aleancës vëren dhe provon diçka të tillë, ka të drejtë të propozojë marrjen e masave ndaj organizatës, forumit, aktivistit, grupimit dhe ta delegojë çështjen direkt në Aleancë, ku më pas ky i fundit vendos mbi masat e posaçme që duhen ndërmarrë (deri në perjashtim të antarit shkeles. Nëpërmjet kësaj synohet shmangia e çdo konflikti dhe keqkuptimi të mundshëm midis organizatave

anëtare të Aleancës, por dhe në të mirë të një bashkëpunimi efektiv me antarët e Aleancës, në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë.

NENI 15

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Rregullorja mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë të paraqitur me shkrim nga Aleanca e Gjelbërt. si dhe nese ka ndryshime keto do te miratohen me shumice te thjeshte votash 50 +1 %

Palët në këtë Rregullore do të bëjnë të gjitha përpjekjet për respektimin e të gjitha rregullave dhe detyrimeve të marra përsipër prej tyre. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Firmosur nga:

Aneksi A

Datë. __/__/__

Procesverbal

I mbajtur sot më datë _____ nga komisioni I vlerësimit të aplikimeve në departamentin _____ e organizatave të Aleancës së Gjelbërt, mbi aplikimet në departamentin e _____ për përzgjedhjen e anëtarëve të këtij departamenti pjesë e aleancës së gjelbërt.

(Plotësohet nga një anëtar eksistues mbi mbledhjen)

Përfaqësuesit e organizatave

1. _____
2. _____
3. _____

Kordinator i departamentit